

Ekskluzive

Ekskluzive | Gëzimi del jashtë kontrollit në Tërnavë të Podujevës – dhëndri feston martesën me kallashnikov, Policia ndërhyr në dasmë



Sinjali.com

01 Gusht 2026 11:01



Atmosfera festive në një dasmë në fshatin Tërnavë të Podujevës u shndërrua në rast policor, pasi dhëndri dyshohet se vendosi ta shënojë ditën e martesës duke shtënë me kallashnikov.

Sinjali mëson se bëhet fjalë për Enis Vllahu, rreth 21-vjeçar, i cili, sipas burimeve, ka pranuar se ka shkrepur me një pushkë automatike AK-47 gjatë ahengut familjar.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti ka ndodhur mbrëmjen e 31 korrikut, rreth orës 22:00, pasi Policia pranoi informacione operative për të shtëna me armë zjarri në lagjen e Vllahive, në fshatin Tërnavë.

Me të mbërritur në vendin e ngjarjes, Enis Vllahu është paraqitur vetë para zyrtarëve policorë dhe ka pranuar se kishte shtënë me armën automatike, duke deklaruar se këtë e kishte bërë për të festuar martesën e tij. Më pas, ai ua ka dorëzuar vullnetarisht policëve AK-47, së bashku me një karikator pa fishekë.

Në vendngjarje është paraqitur edhe Beqir Vllahija, rreth 61-vjeçar, i cili ka deklaruar se posedonte një pistoletë me gaz, por se nuk kishte shtënë me të. Sipas tij, arma ishte në gjendje jofunksionale për shkak të bllokimit të karikatorit.

Të dy janë shoqëruar në Stacionin Policor në Podujevë dhe janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, rasti është iniciuar për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas përfundimit të procedurave, të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet lidhur me rastin vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera